



REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURIYETI

C.nr.1059/12

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Arsim Hamzaj, me sekretaren juridike Majlinda Shala, në kontestin e paditësve E., A., E. dhe E. S., të gjithë nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson av. B. N. nga Prizreni, kundër të paditurve M. H., e vajzërisë S., F. S., S. Q., e vajzërisë S. dhe S. S., të gjithë nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson av. E. R. nga Prizreni, për shkak të anulimit të testamentit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën 13.05.2014, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësve E., A., E. dhe E. S., të gjithë nga Prizreni, përmes të cilës kanë kërkuar që të shpallet i **pa vlefshëm** testamenti me shkrim i përpiluar në Gjykatën Komunale në Prizren, me numër III Ndr.nr.147/97, i datës 29.12.1997, lidhur me paluajtshmërinë-shtëpinë e cila gjindet në Prizren, rr."I. Ll. R." nr..., e evidentuar si ngastër kadastrale nr..., në sipërfaqe prej 160 m2-ndërtesë dhe 241m2-oborr, sipas fletëposedimit nr.2005 ZK Prizren, **si tërësisht e pa bazuar**.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit E., A., E. dhe E. S, të gjithë nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tyre kanë parashtruar padi kundër të paditurve M. H., e vajzërisë S., F. S., S. Q., e vajzërisë S. dhe S. S, të gjithë nga Prizreni, duke theksuar se me aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren, T.nr.232/04, të datës 12.05.2009, është ndërprerë procedura e shqyrtimit të trashëgimisë së të ndjerës A. S., e cila ka vdekur më 20.07.2001 dhe paditësit janë udhëzuar në kontest civil që të provojnë pavlefshmërinë e testamentit me shkrim, i përpiluar pranë kësaj gjykate me numër III-Ndr.nr.147/97, të datës 29.12.1997. Mes tjerash paditësit në padi kanë theksuar se testamenti është përpiluar pa praninë e interpretit – përkthyesit të gjuhës turke, pasi që testamentlënësja nuk e ka njohur gjuhën në të cilën është zhvilluar procedura me rastin e përpilimit të testamentit dhe poashtu e njëjta nuk ka qenë e aftë as fizikisht, as psikikisht të paraqitet para gjykatës. Andaj, kanë theksuar se testamenti është i pa vlefshëm për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave ligjore nga ana e gjykatës për shkak të paafësisë së trashëgimlënësës si dhe për shkak të të metave të saj dhe i kanë propozuar gjykatës që të administrojë provat e propozuara dhe kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Edhe përgjatë shqyrtimit kryesor, i autorizuari i paditësve av. B. N. nga Prizreni, ka ngritur pranë padisë dhe kërkesëpadisë, ndërsa në fjalën e tij të fundit ka theksuar se testamenti, i cili kontestohet në këtë çështje juridike nuk mund të ketë pasojë juridike, ngase nuk është përpiluar në përputhje me dispozitat e vlefshme juridike, pasi që nuk është kontestuese se testamenti është përpiluar në gjuhën serbo-kroate dhe se gjykatësi ka marrë rolin e interpretit dhe nuk ka konstatuar në procesverbal faktin e njohjes së gjuhës nga ana e testamentlënësës dhe mbi bazën e të gjitha të lartcekurave, i ka propozuar gjykatës që testamentin ta shpallë të pa vlefshëm dhe ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësve. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, për specifikimin e të cilave ka marrë obligim që të deklarohet në afat prej 3 dite.

Përmes përgjegjës me shkrim në padi, të paditurit, përmes të autorizuarit të tyre i kanë kontestuar pohimet e paditësve si të pa baza, me arsyetimin se testamentlënësja ka njohur mirë gjuhën në të cilën është zhvilluar procedura, sepse e njëjta ka vijuar shkollimin në gjuhën serbe, propozimi për përpilimin e testamentit është bërë në gjuhën serbe dhe është nënshkruar nga testamentlënësja me shkronja cirilike, që vërtetohet se e njëjta ka njohur gjuhën dhe në bazë të raportit të mjekut-specialist, e njëjta ka qenë e aftë fizikisht dhe psikikisht në momentin e përpilimit të testamentit. Andaj dhe nga arsyet e lartcekura, kanë propozuar që kërkesëpadia e paditësve të refuzohet si e pa bazë.

Edhe përgjatë shqyrtimit kryesor, i autorizuari i të paditurve av. E. R. nga Prizreni, ka deklaruar se mbetet në tërësi si në përgjigjen në padi, ndërsa në fjalën e tij të fundit ka theksuar se nga provat e administruara është vërtetuar se testatorja paraprakisht ka përpiluar një testament te avokati në gjuhën serbo-kroate, por të cilën nuk e ka nënshkruar. Poashtu propozimin për përpilimin e testamentit gjyqësor, e ka përpiluar në gjuhën serbo-kroate dhe testatorja është nënshkruar në alfabetin cirilik dhe sipas kësaj edhe testamenti është përpiluar në të njëjtën gjuhë dhe testatorja është nënshkruar në alfabetin cirilik. Nga dëgjimi i dëshmitarëve është vërtetuar se testatorja ka njohur gjuhën dhe me kërkesën e saj ka hequr dorë nga interpreti dhe me vet faktin se testatorja ka vdekur në moshën 77 vjeçare, rrjedhë se e njëjta shkollimin e ka vijuar në gjuhën serbo-kroate, pasi që në atë kohë nuk ka pasur shkollë në gjuhën shqipe dhe testamenti është përpiluar në gjuhën me të cilën testatorja i është drejtuar gjykatës. Ndërsa sa i përket gjendjes shëndetësore të testatores, me asnjë provë nuk është vënë në dëshim, se e njëjta ka lënguar prej ndonjë sëmundje, andaj dhe nga këto arsye ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzojë si të pa bazë. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: shkresat e lëndës T.nr.232/04; testamentin III Nd.nr.147/97, të datës 29.12.1997; raportin e mjekut specialist – neuropsikiatrit, të datës 15.12.1997; testamentin e përpiluar më datë 23.12.1997 si dhe është bërë dëgjimi i dëshmitarëve I. M. dhe S. D., nga Prizreni.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësve është e pa bazuar.

Nga leximi i shkresave të lëndës T.nr.232/04, gjykata ka konstatuar se në mes të këtu palëve ndërgjyqëse është ndërprerë procedura e shqyrtimit të trashëgimisë për të ndjerën A. S. dhe palët janë udhëzuar në kontestin e rregullt civil për të provuar jo vlefshmërinë e testamentit.

Nga leximi i testamentit numër III Ndr.nr.147/97, të datës 29.12.1997, gjykata ka konstatuar se me të njëjtin testatorja ka përpiluar testament gjyqësor në praninë e dëshmitarëve.

Nga leximi i raportit të mjekut specialist – neuropsikiatrit, të datës 15.12.1997, gjykata ka vërtetuar faktin se testatorja A. S. ka qenë në gjendje të mirë shëndetësore, fizike dhe psikike.

Nga leximi i testamentit të datës 23.12.1997, gjykata ka konstatuar se në emër të të ndjerës A. S. është përpiluar testamenti me datën 23.12.1997 në zyrën e avokatit, mirëpo të njëjtës gjykata nuk ia fali besimin, pasi që është pa nënshkruar nga ana e testatorës.

Gjykata ka dëgjuar në cilësi të dëshmitarit I. M. nga Prizreni, i cili para gjykatës ka deklaruar se ka punuar si gjyqtar në lëminë jo-kontestimore ku i kanë zgjidhur të gjitha çështjet, përfshirë edhe testamentin dhe me kërkesën e palëve kanë shkuar edhe në vendbanimin e palëve dhe në këtë rast, testamenti është përpiluar në banesën e testament-lënësës në lagjen “B.” në Prizren, ku kanë qenë të pranishëm edhe dy dëshmitarë dhe gjatë pregaditjes së procedurës për hartimin e testamentit me palën kanë komunikuar në gjuhën turke, ndërsa me pajtimin e palës testamenti është përpiluar në gjuhën serbo-kroate, pasi që e njëjta e ka kuptuar gjuhën dhe ka deklaruar se e kupton dhe në fund pas njoftimit me pasojat, testamenti është nënshkruar nga testataroja dhe dëshmitarët e pranishëm. Gjithashtu i njëjti ka deklaruar se nuk është angazhuar përkthyesi gjyqësor, pasi që pala e ka njohur gjuhën dhe arsyeja pse ka folur me palën në gjuhën turke, ka qenë sepse e njëjta përsëritet kur kanë hyrë në banesën e saj ia ka bërë në gjuhën turke dhe palëve i është mundësuar përdorimi i gjuhës së tyre vetëm nëse ata e kanë kërkuar.

Gjykata ka dëgjuar në cilësi të dëshmitarit edhe S. D. nga Prizreni, të cilit gjykata pjesërisht ia fali besimin, i cili para gjykatës ka deklaruar se viti nuk i kujtohet, por ka qenë para luftës së vitit 1999 kur e kanë ftuar në një banesë së bashku me R. M. dhe kur kanë arritur aty nga ana e A. S. ka kuptuar se janë ftuar që të jenë dëshmitarë në testamentin, të cilin dëshiron ta përpilojë dhe në ndërkohë ka ardhur edhe gjyqtari dhe i njëjti e ka pyetur se në cilën gjuhë dëshiron të komunikojë ajo-testatorja dhe e njëjta është përgjigjur se i kupton të tri gjuhët si gjuhën shqipe, turke dhe serbo-kroate. Poashtu nga ana e gjyqtarit është pyetur se a dëshiron mjek apo përkthyes dhe e njëjta është përgjigjur se është në gjendje të lë testament dhe nuk i nevojitet përkthyesi dhe komunikimi me të ka vazhduar në gjuhën turke, ndërsa testamenti është përpiluar në gjuhën serbo-kroate, pasi që testatorja ka deklaruar se e ka ndjekur shkollën në gjuhën serbo-kroate.

Duke vepruar sipas udhëzimeve të Gjykatës së shkallës së dytë, gjykata ka administruar provat e lartcekura dhe ka vërtetuar se testatorja ka përpiluar testament gjyqësor në praninë e dëshmitarëve në gjuhën serbo-kroate, gjuha amëtare e testatores ka qenë gjuha turke, se testatorja e ka ditur gjuhën serbo-kroate dhe se në procedurën e përpilimit të testamentit nuk është siguruar përkthyesi i gjuhës turke pasi që këtë nuk e ka

kërkuar pala sepse e ka njohur gjuhën, andaj dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me nenin 88 të ligjit për Trashëgiminë (ligj i cili ka qenë në fuqi në kohën e përpilimit të testamentit) është paraparë se “*Nëse testatori nuk është në gjendje që ta lexojë testamentin që ia ka përpiluar gjyqtari, ky ia lexon testatorit në praninë e dy dëshmitarëve, e pastaj testatori në praninë e këtyre dëshmitarëve deklaron se testamenti është i tij dhe e nënshkruan testamentin ose e vë në të shenjën e gishtit tregues*”. Ndërsa me nenin 187 par. 1 të Ligjit për procedurën jashtë-kontestimore (ligj i cili ka qenë në fuqi në kohën e përpilimit të testamentit) është e paraparë se “*në qoftë se testamenti është përpiluar në praninë e dy dëshmitarëve për shkak se trashëgimlënësi nuk di të lexojë, gjyqtari do t’ia lexojë testamentin e pastaj trashëgimlënësi, pasi të deklarojë se është testamenti i tij, në praninë e dëshmitarëve do ta nënshkruajë ose do të vë në të gjurmën e gishtit tregues*”, ndërsa me paragrafin e dytë të po këtij neni është paraparë se “*Në qoftë se trashëgimlënësi nuk di gjuhën që është në përdorim zyrtar në gjykatë ose është memec ose i shurdhër, gjyqtari me anë të interpretit të betuar do të lexojë testamentin, kurse trashëgimlënësi me anë të interpretit do të deklarojë se testamenti është i tij*”.

Poashtu me nenin 96 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) është paraparë se “*palët dhe pjesëmarrësit tjerë në procedurë kanë të drejtë që në procedurën para gjykatës të përdorin gjuhën e vet apo gjuhën të cilën e kuptojnë*”, ndërsa në paragrafin 2 të të njëjtit nen është paraparë “*Në qoftë se procedura nuk zhvillohet në gjuhën e palës, gjegjësisht të pjesëmarrësve tjerë në procedure, do të sigurohet sipas kërkesës së tyre përkthimi gojarisht në gjuhën e tyre apo në gjuhën që e kuptojnë, i të gjitha parashtresave dhe provave shkresore, si dhe i asaj që parashtrahet në seancë gjyqësore*”. Ndërsa në nenin 7 të të njëjtit ligj është paraparë se “*Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla*”.

Duke marr parasysh të gjitha pretendimet e palëve ndërgjyqëse si dhe provat e administruara në lidhje me këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është e pa bazuar dhe se njejtja duhet të refuzohet në tërësi, sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjykata ka vendosur në këtë mënyrë, para se gjithash, duke marr parasysh faktin se kërkesa e testatores për përpilimin e testamentit është parashtruar në gjuhën serbo-kroate dhe në të e njëjta është nënshkruar me shkronja cirilike, e cila kërkesë len të kuptohet se testatorja e ka ditur gjuhën serbo-kroate. Po ashtu edhe në procesverbalin-testamentin e Gjykatës Komunale në Prizren i përpiluar në gjuhën serbo-kroate testatorja ka nënshkruar me shkronja cirilike e që është i njëjti nënshkrim si në kërkesën për përpilimin e testamentit. Në këtë procesverbal-testament në cilësinë e dëshmitarit është edhe emri i S. D., i cili në këtë çështje kontestimore është dëgjuar si dëshmitar, i cili para kësaj gjykate ka deklaruar se procesverbali është përpiluar në gjuhën serbo-kroate me pëlqimin e testatores pasi që ka deklaruar para gjyqtarit se i njuh të tri gjuhët si gjuhën turke, shqipe dhe gjuhën serbo kroate dhe e njëjta edhe e ka nënshkruar procesverbalin. Kësaj pjesë të dëshmisë së dëshmitarit S. D., gjykata ia fali besimin. Po ashtu edhe nga dëgjimi i dëshmitarit I. M. të cilit është konstatuar se testatorja e ka njohur gjuhën serbo-kroate dhe ka pranuar qe procedura të zhvillohet në këtë gjuhë, pasi që sipas ligjit përkthyesi është siguruar vetëm me kërkesën e palëve mirëpo kjo nuk është konstatuar në proces dhe e njëjta-testatorja në fund e ka nënshkruar testamentin. Këtyre provave gjykata gjithashtu ia fali besimin, ngase janë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të lartcekura si dhe gjendjen faktike të vërtetuar. Në anën tjetër, gjykata nuk i mori për bazë pretendimet e paditësve se testatorja nuk e ka ditur gjuhën në të cilën është zhvilluar procedura si dhe e njëjta nuk ka qenë në gjendje të mirë

shëndetësore që të jep testament, pasi që të njëjtat janë në kundërshtim me provat e administruara.

Mbi bazën e të lartcekurave dhe duke qenë se paditësit nuk i kanë ofruar gjykatës prova të mjaftueshme dhe bindëse, përmes të cilave do të argumentohet drejta e tyre në anulimin e testamentit, kjo gjykatë nuk mundi ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësve, respektivisht të njëjtën u deshtë që ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Në lidhje me shpenzimet procedurale, gjykata vendosi konform nenit 452 dhe 463.1 të LPK-së, pasi që pala paditëse i ka kërkuar shpenzimet por për të njëjtat nuk i ka specifikuar, ndërsa pala e paditur nuk i ka kërkuar shpenzimet procedurale.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.1059/12, datë 13.05.2014

Sekretarja juridike
Majlinda Shala

Gjyqtari
Arsim Hamzaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.